



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 10.01.2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr.03, datë 10.01.2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje nenit 78/1/a të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "ATLANTIK 3" shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim, për qëllime kualifikimi, në procedurat e prokurimit me objekt: "*Materiale Pastrimi dhe Dizinfektimi*", zhvilluar në datë 10.02.2020 nga Ndërrmarja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve Korçë, me objekt: "*Blerje Klori për nevojat e shoqërisë*", të zhvilluar në datë 29.01.2021 nga Ujësjellës Kanalizime Gramsh sh.a" dhe objekt: "*Blerje hipoklorit kalciumi për vitin 2021*" zhvilluar në datë 05.02.2021 nga Ujësjellës Kanalizime Mallakastër sh.a

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "ATLANTIK 3" shpk, me NIPT K22218003V me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, km.10, Vorë.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "ATLANTIK 3" shpk, ka nisur me kërkesë të operatorit ekonomik "Albanian Distribution Chemicals" Shpk, për përjashtimin e operatorit ekonomik "ATLANTIK 3" shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, në zbatim të nenit 78/1/a të LPP, me pretendimin se, operatori ekonomik "ATLANTIK 3" shpk ka keqinformuar, për qëllime kualifikimi, në procedurat e prokurimit të sipërcituara.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit, për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 78/1/a të LPP, në dy nga procedurat e prokurimit të sipërcituara.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 03 datë 10. 01.2022, APP ka vendosur të përjashtojë për 3 (tre) muaj operatorin ekonomik "ATLANTIK 3" shpk me NIPT K22218003V nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin që, operatori ekonomik "ATLANTIK 3" shpk, nuk nuk ka qenë i përjashtuar më parë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, ka keqinformuar, por nuk ka ndërhyrë në dokumenta, si dhe nuk ka përfituar fonde publike, pasi është skualifikuar.